

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 Gusht 2010), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-150 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03 prill 2017), si dhe nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.3, të Ligjit nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.12/03 maj 2013), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 29 nëntor 2023, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR STRUKTURËN DHE PËRDORIMIN E IDENTIFIKUESIT UNIK TË LLOGARISË TË PAGESËS PËR TRANSAKSIONET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për përdorimin, strukturën dhe komunikimin e IBAN si identifikues unik i llogarisë së pagesës për transaksionet e transferit të kreditit dhe debitimet direkte në Republikën e Kosovës dhe ato ndërkombëtare.
2. Për më tepër, kjo rregullore gjithashtu përcakton kërkesat lidhur me procedurat për kontrollin e vlefshmërisë së identifikuesit unik të llogarisë së pagesës nga ana e ofruesve të shërbimeve të pagesave.

Neni 2 Qëllimi i përdorimit të IBAN si kod unik i identifikimit të llogarisë së pagesës

1. IBAN përdoret nga ofruesi i shërbimit të pagesave me qëllim të:
 - 1.1. Identifikimit të llogarisë së pagesës, duke përdorur një format të standardizuar të paraqitjes së saj;
 - 1.2. Përpunimit automatik në proceset e ndërlidhura me llogarinë e pagesës;
 - 1.3. Unifikimit dhe standardizimit të procesit të kontrollit të vlefshmërisë së llogarisë së pagesës.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Subjekte të zbatimit të kësaj Rregulloreje janë të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të cilët ofrojnë shërbime të pagesave në Republikën e Kosovës (BQK).

2. BQK-ja zbaton dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me sistemet e pagesave dhe infrastrukturën me të cilën operon kur vepron si ofrues i shërbimit të pagesave.

Neni 4 **Përkufizime**

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet në paragrafin vijues ose parashikohet ndryshe në mënyrë specifike, për qëllimet e kësaj Rregulloreje dhe të çdo mase tjetër që e zbaton atë, termat do të kenë të njëjtin kuptim siç përcaktohet në Ligjin Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare dhe Ligjit Nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave.
2. Kudo që përdoren në tekstin e kësaj rregulloreje, dhe nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin e mëposhtëm:
 - 2.1. **Ofrues i Shërbimit të Pagesave ose OSHP** – nënkupton çdo person fizik ose juridik të licencuar, regjistruar ose autorizuar sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për të ofruar shërbim pagese;
 - 2.2. **Numri bazë i llogarisë bankare** ose BBAN- do të thotë një identifikues i cili në mënyrë të qartë identifikon një llogari individuale pagese me një OSHP;
 - 2.3. **Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare** ose IBAN- nënkupton identifikuesin unik të llogarisë së pagesës i cili në mënyrë të qartë identifikon një llogari individuale pagese me një OSHP, elementët e së cilës janë të specifikuara nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO);
 - 2.4. **SWIFT**- nënkupton Shoqërinë për Telekomunikacionin Financiar Ndërbankarë në mbarë botën;
 - 2.5. **BIC** - nënkupton një kod identifikues biznesi që identifikon pa mëdyshje një OSHP, elementët e të cilit janë të specifikuara nga ISO;
 - 2.6. **Transaksion pagese**- do të thotë një akt, i iniciuar nga paguesi ose në emër të tij ose nga përfituesi, i vendosjes, transferimit ose tërheqjes së fondeve, pavarësisht nga çdo detyrim themelor ndërmjet paguesit dhe përfituesit;
 - 2.7. **Llogari e pagesës**- nënkupton një llogari të mbajtur në emër të një ose më shumë
 - 2.8. përdoruesve të shërbimeve të pagesave (PSHP) e cila përdoret për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave;
 - 2.9. **Identifikues i llogarisë së pagesës**- nënkupton BBAN dhe IBAN;
 - 2.10. **Debitim direkt**- nënkupton një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesave të një paguesi, ku një transaksion pagese inicohet nga përfituesi në bazë të pëlqimit të dhënë nga paguesi për përfituesin, ose për ofruesin e shërbimit të pagesave të përfituesit ose për ofruesin e shërbimit të pagesave të vet paguesit;
 - 2.11. **Transfer krediti** -nënkupton një shërbim pagese për kreditimin e llogarisë së pagesës së përfituesit me një transaksion pagese ose një seri transaksionesh pagese nga llogaria e pagesës së një paguesi nga ofruesi i shërbimit të pagesave që mban llogarinë e pagesave të paguesit, bazuar në një udhëzim të dhënë nga paguesi;
 - 2.12. **Përdorues i shërbimit të pagesave** ose PSHP- nënkupton një person fizik ose juridik që përdor shërbimin e pagesave në cilësinë e paguesit, përfituesit ose të dyja bashkë;

- 2.13. **Pagues**- nënkupton personin fizik ose juridik që mban një llogari pagese dhe lejon një urdhërpagesë nga ajo llogari pagese, ose, kur nuk ka llogari pagese, një person fizik ose juridik që jep urdhërpagesë;
- 2.14. **Përfituesi i pagesës/ i paguar**- nënkupton një person fizik ose juridik i cili është pranuesi i synuar i fondeve që kanë qenë objekt i një transaksioni pagese;
- 2.15. **Kodi identifikimit të OSHP ose KIO** - nënkupton kodin numerik për identifikimin e një OSHP dhe degëve të saj aty ku është e aplikueshme, për të kryer aktivitete bankare dhe financiare brenda territorit të Republikës së Kosovës;
- 2.16. **ISO** - nënkupton Organizatën Ndërkombëtare për Standardizim;
- 2.17. **Kontroll i vlefshmërisë IBAN**- nënkupton përcaktimin e saktësisë së shifrës së kontrollit IBAN;
- 2.18. **Urdhërpagesë** - nënkupton një udhëzim nga paguesi ose i paguari për ofruesin e tij të shërbimit të pagesave që kërkon ekzekutimin e një transaksioni pagese;
- 2.19. **Karakteret numerike** - janë karakteret që bëjnë pjesë në bashkësinë e numrave nga 0 deri në 9;
- 2.20. **Karakteret alfabetike** – janë karakteret që bëjnë pjesë në bashkësinë e shkronjave të mëdha të alfabetit anglez nga A në Z;
- 2.21. **Karakteret alfanumerike** – janë të gjitha karakteret numerike dhe alfabetike;
- 2.22. **Shërbimi i pagesës** - nënkupton çdo aktivitet, të kryer sipas dispozitave ligjore dhe rregullatore në fuqi, për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave.

Neni 5

Përdorimi i detyrueshëm i IBAN-it

1. Përdorimi i IBAN-it është i detyrueshëm si identifikues i llogarisë së pagesave për identifikimin e llogarive të pagesave në lidhje me transferet e kreditit dhe debitimet direkte.
2. Numrat e llogarive të pagesave të PSHP-ve të cilët mund të përdoren për kryerjen e transaksioneve të pagesave, duhet të kenë formatin IBAN sipas përcaktimit të kësaj rregulloreje.
3. Për të ekzekutuar një transaksion pagese, OSHP-ja kërkon nga paguesi IBAN-in e përfituesit, si dhe BIC kodin e OSHP-së së përfituesit në rastet kur është i aplikueshëm.
4. Sipas rregullave në fuqi OSHP mund të refuzojë të ekzekutojë transaksionin e pagesës, nëse OSHP-ja nuk paraqet IBAN-in e llogarisë së pagesës së përfituesit dhe/ose kodin BIC të OSHP-së së përfituesit aty ku është e aplikueshme. Në rast refuzimi OSHP-ja duhet të njoftojë PSHP-në pa vonesa.
5. OSHP-të mund të aplikojnë tarifa shtesë për kryerjen e transaksioneve të pagesave, në rastet kur PSHP-të nuk paraqesin IBAN-in e përfituesit dhe/ose kodin BIC të OSHP-së të përfituesit. Në raste të tilla, para ekzekutimit të transaksioneve OSHP-të duhet të njoftojnë PSHP-në me shkrim për tarifën shtesë të aplikueshme.
6. Në rastin e pagesave ndërkombëtare OSHP-të zbatojnë dispozitat e pikave 3,4 dhe 5 të këtij neni, kur IBAN përdoret nga OSHP-ja e përfituesit në juridiksionin përkatës.

KAPITULLI II

STRUKTURA E KODEVE TË IDENTIFIKIMIT TË LLOGARISË SË PAGESËS

Neni 6

Struktura e IBAN-it

1. IBAN-i në Republikën e Kosovës përbëhet prej 20 karakteresh alfanumerike dhe përfshin elementet e mëposhtme:
 - 1.1. Në pozicionin 1 dhe 2 kodi i Republikës së Kosovës, që është i përbërë prej 2 karaktereve: “XK“, të cilat janë të përcaktuara në regjistrin e IBAN-it në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 3166-1;
 - 1.2. Në pozicionin 3 dhe 4, shifra e kontrollit të IBAN-it, që është i përbërë prej 2 karaktereve, të cilat përcaktohen në përputhje me algoritmin MOD 97-10 në bazë të standardit ndërkombëtar ISO 7064, siç është shpjeguar në shtojcën 2 të kësaj rregullore;
 - 1.3. Në pozicionet 5 deri 20, BBAN në Republikën e Kosovës siç specifikohet në nenin 7 të kësaj rregullore.

Neni 7

Struktura e BBAN

1. BBAN-i përbëhet prej 16 karaktereve numerike dhe përfshinë elementet e mëposhtme:
 - 1.1. KIO, që është i përbërë nga 4 karaktere numerike në pozicionet 1 deri 4, që identifikojnë në mënyrë unike OSHP-në dhe degën e saj në të cilën është hapur llogaria e pagesës së PSHP-ve;
 - 1.2. Numri i PSHP-ve, që është i përberë nga 10 karaktere numerike në pozicionet 5 deri 14, të cilat përcaktohen nga vet OSHP-ja;
 - 1.3. Kodi kontrollues i BBAN-it, i përbërë nga 2 karaktere numerike, pozicionet 15 dhe 16 të cilat përcaktohen në përputhje me algoritmin MOD 97-10 në bazë të standardit ndërkombëtar ISO 7064.

Neni 8

Struktura e KIO

1. KIO përbëhet nga 4 karaktere numerike:
 - 1.1. Kodi i OSHP-së, i përbërë nga 2 karaktere, pozicionet 1 dhe 2, të cilat përcaktohen nga BQK-ja për të identifikuar në mënyrë unike çdo OSHP. Ky kod mund të jetë nga “10” deri në “99”; kodi “10” është i rezervuar për BQK-në, kodet prej “11” deri “49” janë të rezervuara për bankat, kurse kodet prej “50” deri “99” janë të rezervuara për OSHP-të të cilat nuk janë banka.
 - 1.2. Kodi i degës së OSHP-së, që është i përbërë nga 2 karaktere, pozicionet 3 dhe 4, që përcaktohen nga OSHP-ja për të identifikuar në mënyrë unike çdo degë të saj. Ky kod mund të jetë nga “00” deri në “99”. Për degën kryesore të OSHP-së, ky kod duhet të jetë “00”.
2. Sa i përket kodit të OSHP-së, BQK:

- 2.1. Bënë përcaktimin e KIO-së në mënyrë rendore pas dhënies së licencës së OSHP-ve;
- 2.2. Mirëmban dhe publikon Regjistrin e OSHP-ve;
- 2.3. Informon OSHP-të, për çdo ndryshim në Regjistrin e Kodeve të OSHP-ve;
- 2.4. Informon organizatat e huaja relevante në bazë të aranzhmaneve të veçanta për çdo ndryshim në regjistrin e kodeve të OSHP.

KAPITULLI III

PROCEDURAT DHE DETYRIMET E LIDHURA ME IBAN

Neni 9

Forma e paraqitjes

1. IBAN-i duhet të paraqitet si më poshtë:
 - 1.1. Në urdhërpagesat në format elektronik: pa hapësira ose simbole ndarëse në mes të karaktereve përbërëse;
 - 1.2. Në urdhërpagesat në format letre: pa hapësira ose simbole ndarëse në mes të karaktereve përbërëse ose sipas grupimit prej 4 karakteresh të ndara me nga një hapësirë.

Neni 10

Krijimi dhe komunikimi i IBAN-it

1. OSHP-të duhet të krijojnë një IBAN për çdo llogari pagese individuale në momentin e hapjes së kësaj llogarie në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.
2. OSHP-të përgjigjen përpara PSHP-së që mban llogarinë e pagesave për saktësinë e IBAN-it të vendosur.
3. OSHP-të do të ofrojnë IBAN-in e llogarisë së çdo PSHP-je në format të shkruar me kërkesë të PSHP-së ose në formë elektronike në një mënyrë lehtësisht të arritshme.

Neni 11

Metoda e aplikueshme për të kontrolluar vlefshmërinë e IBAN-it

1. Kontrollimi i vlefshmërisë së IBAN-it bëhet duke llogaritur vlerën e shifrës së kontrollit dhe duke verifikuar nëse ajo përfaqësohet saktësisht në karakteret që përfaqësojnë shifrën kontrolluese në IBAN. Nëse shifra e llogaritur e kontrollit përputhet me paraqitjen në karakteret përkatëse në IBAN, atëherë ai IBAN quhet i vlefshëm.
2. Kontrolli i vlefshmërisë së IBAN-it kryhet në përputhje me mënyrën e llogaritjes së shifrave të kontrollit IBAN, të përcaktuar në shtojcën 2 të kësaj rregullore.

Neni 12

Kontrollimi i vlefshmërisë së IBAN-it përpara ekzekutimit

1. Përpara ekzekutimit të një transaksioni të pagesës, OSHP-ja duhet të kontrollojë vlefshmërinë e IBAN-it dhe përputhshmërinë e IBAN-it me BIC-in ku është e zbatueshme, të llogarive të pagesave

të paguesit dhe të përfituesit (me rastin e pranimit dhe dërgimit), pavarësisht nga prezantimi i IBAN-it në format elektronik ose në letër. Në rast se procedurat e vërtetimit të IBAN-it tregojnë se IBAN-i është i pavlefshëm, OSHP-ja do të refuzojë ekzekutimin e transaksionit përkatës.

2. Sistemet e pagesave duhet të kontrollojnë vlefshmërinë e IBAN-it dhe përputhshmërinë e IBAN-it me BIC-në për transaksionet e pagesave që kryhen nëpërmjet këtyre sistemeve dhe në rast se IBAN-i rezulton i pavlefshëm, ata refuzojnë të procesojnë transaksionin e pagesës përkatëse.
3. Kontrollimi i vlefshmërisë së IBAN-it sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje është parakusht për vazhdimin e ekzekutimit të transaksionit të pagesës.

Neni 13

IBAN i pasaktë

1. Nëse urdhërpagesa ekzekutohet në përputhje me IBAN-in e dhënë nga PSHP-ja, urdhërpagesa do të konsiderohet se është ekzekutuar në mënyrë korrekte në lidhje me përfituesin e përcaktuar nga IBAN-i dhe i vërtetuar në përputhje me nenet 11 dhe 12 të kësaj rregullore.
2. Nëse IBAN-i i dhënë nga PSHP-të është i pasaktë, OSHP-ja nuk do të mbajë përgjegjësi për mosekzekutimin apo ekzekutimin e parregullt të transaksionit të pagesës.
3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, OSHP-ja e paguesit do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të kthyer fondet e përfshira në transaksionin e pagesës dhe OSHP-ja e përfituesit gjithashtu do të bashkëpunojë në këto përpjekje, duke i komunikuar OSHP-së së paguesit të gjithë informacionin përkatës për kthimin e fondeve.
4. Në rast se kthimi i fondeve sipas paragrafit të mëparshëm nuk është i mundur, OSHP-ja e paguesit duhet t'i sigurojë paguesit, pas një kërkesë me shkrim, të gjithë informacionin që disponon OSHP-ja e paguesit dhe që janë të rëndësishme për paguesin, me qëllim që paguesi të paraqesë një kërkesë ligjore për të kthyer fondet.
5. Nëse është rënë dakord në kontratën përkatëse që rregullon shërbimin e pagesave, OSHP-ja mund të ngarkojë PSHP-në me tarifë për kthimin e fondeve.

KAPITULLI IV

FUNKSIONET LIDHUR ME KIO

Neni 14

Funksionet e BQK-së në lidhje me KIO

1. Në lidhje me KIO, BQK-ja do të veprojë sa vijon:
 - 1.1. Pas autorizimit të një OSHP për të kryer shërbimet e pagesave dhe/ose emetimin e parave elektronike, BQK-ja cakton dhe i komunikon OSHP-së pjesën e parë të KIO (karakteret 1 dhe 2);
 - 1.2. Pajisë OSHP-të me dy karakteret e para të KIO-së siç përcaktohet në këtë rregullore;
 - 1.3. Konfirmon saktësinë e pjesës së KIO-së të përcaktuar nga OSHP për degët e saj sipas nenit 7 të kësaj rregullore;

- 1.4. Informon pjesëmarrësit në sistemet e pagesave që operon për caktimin e KIO-ve të reja, si dhe mbylljen e KIO-ve;
- 1.5. Mbanë, përditëson dhe publikon listën e kodeve KIO, në formatin e dhënë në shtojcën 3 të kësaj rregulloreje, dhe;
- 1.6. Informon SWIFT-in për ndryshimet në listën e kodeve KIO, gjë e cila mund të bëhet me anë të publikimit të listës në faqen zyrtare të BQK-së.

Neni 15

Detyrimet e OSHP-ve në lidhje me KIO

1. OSHP-të duhet të njoftojnë BQK-në menjëherë për çdo ndryshim në kodet KIO të OSHP-ve, duke përfshirë caktimin ose mbylljen e KIO-ve për cilëndo nga degët e saj ose çdo ndryshim tjetër për të cilin mund të jetë e nevojshme të bëhen përditësime përkatëse në listën e publikuar të kodeve KIO.
2. OSHP-të nuk mund të ndryshojnë karakteret e një KIO ekzistuese, por mund ta mbyllin atë.
3. Në rastin e përfundimit të një KIO ekzistuese, OSHP-ja duhet të sigurohet për administrimin e duhur të IBAN-ve të lëshuara me atë KIO që do të mbyllet, në përputhje me rregullat përkatëse të zbatueshme për llogaritë e pagesave.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet

Çdo shkelje e dispozitave e kësaj Rregulloreje do të jetë subjekt i masave ndëshkuese, siç përcaktohet në Ligjin për Bankën Qendrore dhe Ligjin për Sistemin e Pagesave.

Neni 17

Shtojcat

1. Tre shtojca janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. Shtojca 1 -Struktura e IBAN-it;
 - 1.2. Shtojca 2 - Mënyra e llogaritjes së kodeve të kontrollit IBAN;
 - 1.3. Shtojca 3 - Formati për publikimin e listës së kodeve të OSHP-ve dhe degëve të tyre.

Neni 18

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet “Rregullorja për Sistemin e Numrave Standardë të Llogarive Bankare” e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore më 22 dhjetor 2015.

Neni 19
Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2024. OSHP-të duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e kësaj rregullore më së largu deri më 30 qershor 2024.

Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Shtojca 2

Metoda e llogaritjes së shifrave kontrolluese të BBAN-it dhe IBAN-it

Me instruksionet në vazhdim, tregohet se si llogariten shifrat kontrolluese të BBAN-it dhe IBAN-it. Për këtë qëllim marrim një llogari IBAN e cila përfshin kodin e Kosovës “XK”.

Si algoritëm për caktimin e shifrave të kontrollit përdoret standardi ndërkombëtar ISO 7064, MOD 97-10.

Shembull: X K 0 5 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Llogaritja e numrit kontrollues të BBAN-it: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Hapi 1

Siç dihet BBAN paraqet 16 shifrat e fundit të IBAN-it.

Së pari dy shifrat e kontrollit të BBAN-it zëvendësohen me “00”: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 00

Hapi 2

Në shifrën nga Hapi 1 zbatohet algoritmi MOD 97. Mbetja nga zbatimi i MOD 97 në shifrën nga Hapi 1 është numri “92”.

Hapi 3

Rezultati nga Hapi 2 zbritet nga numri 98, i cili paraqet shifrën e kontrollit të BBAN-it. Në rastin tonë shifra e kontrollit është “06”: $98 - 92 = 06$.

Në rastet kur shifra është një shifrore atëherë shtohet “0” para rezultatit të fituar.

Numri BBAN ku përfshinë shifrën e kontrollit nga Hapi 3 është; 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 06

Për të vërtetuar saktësinë e BBAN-it atëherë, mbetja pas aplikimit të MOD 97 në BBAN (1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 06) duhet të jep rezultatin “1”.

Llogaritja e numrit kontrollues të IBAN-it: X K 0 5 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Hapi 1

Kodin e shtetit dhe shifrën e kontrollit i zhvendosim në fund, pastaj shifrën e kontrollit e zëvendësojmë me “00” ndërsa shkronjat “XK” zëvendësohen me numra sipas tabelës së më poshtme:

A = 10	G = 16	M = 22	S = 28	Y = 34
B = 11	H = 17	N = 23	T = 29	Z = 35
C = 12	I = 18	O = 24	U = 30	
D = 13	J = 19	P = 25	V = 31	
E = 14	K = 20	Q = 26	W = 32	
F = 15	L = 21	R = 27	X = 33	

Rezultati: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 X K 0 0, pas konvertimit të shkronjave kemi numrin
1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 3 3 2 0 0 0.

Hapi 2

Zbatohet MOD 97 në rezultatin e fituar në Hapin 1: 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 3 3 2 0 0 0. Mbetja nga zbatimi i MOD 97 në rezultatin nga Hapi 1 është numri “93”.

Hapi 3

Rezultati nga Hapi 2 zbritet nga numri 98, i cili paraqet kodin kontrollues të IBAN-it. Në rastin tonë, kodi kontrollues është “05”: $98-93 = 05$. (Në rastet kur rezultati i fituar ka vetëm një karakter, atëherë shtohet “0” para rezultatit të fituar.)

Numri IBAN, i cili përfshin kodin kontrollues nga Hapi 3 është X K 05 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6

Për të vërtetuar saktësinë e IBAN-it, së pari kodin e shtetit dhe kodin kontrollues i zhvendosim në fund, si dhe shkronjat “XK” i konvertojmë në numra. Mbetja pas aplikimit të MOD 97 në shifrën e përgatitur (1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6 33 20 0 5) duhet të japë rezultatin “1”.

Shembull i zbatimit të MOD 97

I referohemi shembullit të zbatimit të MOD 97 në BBAN (1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6):

- I. 9 shifrat e para të numrit pjesëtohen me 97
 $121201234/97 = 1249497.257$
- II. pjesa e plotë e rezultatit të fituar shumëzohet me numrin 97
 $1249497 * 97 = 121201209$
- III. nga numri i parë 9 shifror zbrisim numrin e marrë nga rezultati në hapin 2
 $121201234 - 121201209 = 25$
- IV. e krijojmë numrin e ri i përberë nga rezultati nga hapi 3 dhe 7 numrat në vazhdim të shifrës së BBAN-i dhe këtë numër e pjesëtojmë me 97.
 $255678906/97 = 2635865.01$
Në rastin tonë, në këtë hap kemi përfshirë të gjithë shifrat, në të kundërtën kjo procedurë përsëritet deri sa të përfshihen në llogaritje të gjithë numrat.
- V. pjesa e plotë e rezultatit të fituar shumëzohet me numrin 97
 $2635865 * 97 = 255678905$
- VI. nga numri i përgatitur në hapin 4 zbrisim rezultatin në hapin 5.
 $255678906 - 255678905 = 1$

Rezultati i fituar paraqet mbetjen nga kalkulimi i MOD 97 të shifrës 1 2 1 2 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9 0 6.

Shtojca 3

Formati për publikim i listës së kodeve të OSHP-ve dhe degëve të tyre

1. Lista e kodeve të OSHP-ve dhe degëve të tyre, do të përmbajë të dhënat nga tabela në vazhdim dhe do të publikohet si dokument në format të "excel"-it.
2. Ky dokument do të përmbaj dy faqe(sheet), në të cilën njëra do jetë lista e OSHP-ve banka, ndërsa tjetra lista e OSHP-ve jo banka.
3. Ne emrin e dokumenti të publikuar do të vendoset data e fundit e azhurnimit të tij.

	KIO		Të dhënat e OSHP-së dhe degëve të saj				
BIC kodi	Kodi i OSHP-së	Kodi i degës	Emri i OSHP-së	Emri i degës	Adresa e degës	Kodi postal i degës	Data e azhurnimit